




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO AGENCY AGAINST CORRUPTION ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. 01-3836/12		
Dep. 02	Pror. No. 24.10.2012		
Nr. i llog. Broj. sh. sh. Nr. pape:	Data Dënim. Datë:		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.09.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-688-12, për znj. *Eljana Naka* – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej kjo Zyrtare e lartë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-688-12, për Zyrtaren e lartë, znj.Eljana Naka – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtarja e lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtares së lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtarja e lartë, znj.Naka, është paraqitur, në takim me zyrtaret e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtarja e lartë, znj. Eljana Naka ka dërguar disa shkresa të brendshme të ndërmarrjes të cilat ajo kishte funksion menaxhues, e me të cilat ajo sqaron se ky biznes nuk ka aktivitet dhe është pasiv.

Por, Agjencioni kundër korrupsionit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar nga zyrtarja e lartë që të shmangë konfliktin e interesit, duke zgjedhur një nga dy funksionet e mundshme, ose funksionin publik si Sekretare e përgjithshme në MTI, ose person i autorizuar e menaxhues i ndërmarrjes private "Waterman-Kosova" sh.p.k., funksione këto që, sipas ligjit (Nr.04/L-051) janë të papajtueshme dhe sjellin situatën e konfliktit të interesit.

Pas shkresës së dytë nga Agjencia (Z.D./DPK-03-3077/12), që ndryshe quhet Paralajmërim, zyrtarja e lartë, znj.Naka, ka bërë ndryshimet e nevojshme duke u tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar dhe menaxhues në ndërmarrjen private, dhe duke vazhduar ta kryej vetëm funksionin e vet publik si Sekretare e Përgjithshme në MTI.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, znj.Naka, me datën 18.09.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, me informacionet e reja mbi biznesin "Waterman Kosova" Sh.p.k. (DPK.DPKI-03-3295/12) , në të cilat shihet se ajo, tashmë, nuk ushtron asnjë funksion në këtë biznes.

Në bazë të këtij dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

